



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 10.02.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.02.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Euroconstruction" për aktivitetin: "Rregullimi i dyreve dhe dritareve në Institucionet Arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-7534-521 nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Euroconstruction" e datës 08.02.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i dyreve dhe dritareve në Institucionet Arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-7534-521, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 03.02.2021*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Anulohet *Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 03.02.2021 dhe aktiviteti kthehet në rivleresim;*
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**Euroconstruction**" me datë 08.02.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i dyreve dhe dritareve në Institucionet Arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-7534-521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 06.07.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi se tenderuesi i propozuar për dhenje të kontratës është i pa përgjegjshëm sepse në formularin e tenderit nuk ka shënuar çmimin e peshuar është pjesërisht i bazuar;

-Pretendimet se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar dispozitat ligjore lidhur me referencat e dorezuara nuk qëndrojnë, pasi që edhe nuk është dorezuar lista e kontratave, ekzistojnë dëshmitë që e plotëson kërkesën e Autoritetit Kontraktues dhe ajo nuk mund të jetë arsye për refuzim të tenderit;

-Pretendimi tjetër se tenderuesi i propozuar për dhenje të kontratës është i pa përgjegjshëm për shkak të nderhyrjes në paramasa dhe paralogari është i bazuar pasi që në pozicionin 2 ku ka pasë njësinë 1 ka vendosur sasinë 300 dhe në këtë mënyrë ka bërë nderhyrje të pa ligjshme në dokument.

Bazuar në sqarimet e dhëna për pretendimet tuaja u vendos si në dispozitiv, pra aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Zyrtari që administron aktivitetin duhet të kërkojë propozimet për komisionin e rivlerësimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

